



Data: 11.02.2020

Ref.: 146/20D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 79-të, të mbajtur më 16 dhe 17.01.2020, mori:

V E N D I M

I. Nuk akreditohet programi i Kolegjit ISPE:

- Infermieri, BSc, 180 ECTS

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Kolegji ISPE ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programit të studimit të cekur në dispozitiv të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën e akreditimit në Kolegjin ISPE më datë 25.10.2019 me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Dr. Danica Zeleznik dhe znj. Delia Gologan.

Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 16 dhe 17.01.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit ISPE dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtar të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me këtë program të studimit, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit kanë konstatuar se programi plotëson vetëm pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit.

Ekspertët kanë konstatuar se nga gjithsej shtatë (7) kapituj të standardeve të Manualit të Akreditimit, Kolegjit ISPE për këtë program të studimit plotëson dy (2) substancialisht dhe pesë (5) pjesërisht, dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar mosdhënien e riakreditimit.

Ekipi i ekspertëve ndër të tjera ka konstatuar një varg mangësish të cilat kanë qarë në mosdhënien e akreditimit. Sa i përket kapitullit të standardeve që ka të bëjë me menaxhimin e cilësisë, ekipi i ekspertëve ka konstatuar se kolegji nuk ka arritur të dëshmojë se posedon politika dhe procese të qarta për sigurim të cilësisë. Për më tepër sipas ekipit të ekspertëve programi i përbashkët do të duhej të kishte një qasje krejtësisht të re sa i përket sigurimit të cilësisë, pra një qasje që mbulon të gjitha pjesët e programit, edhe ato që zhvillohen në Finlandë edhe ato në Kosovë, por me një bazë të të dhënave të përbashkët në nivel të programit për t'i shërbyer përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Ekspertët mendojnë se me kalimin e kohës dhe me përkrahje të partnerit nga Finlanda, Kolegji ISPE do të mund të përgatitet për një qasje të tillë të sigurimit të cilësisë në të ardhmen, por jo për këtë vit akademik.

Megjithëse në RVV potencohet se kontratat e punës të stafit akademik dhe atij administrativ përcaktojnë vlerësimin e stafit dhe procesin e planifikimit për vlerësim periodik dhe përmirësim, ekspertët nuk kanë gjetur dëshmi se Kolegji ISPE posedon kapacitete për dizajnimin dhe zbatimin e një kalendari të tillë të vlerësimit.

Sa i përket kapitullit të standardeve që ka të bëjë me stafin akademik, ekspertët kanë gjetur se pjesa më e madhe e stafit akademik janë të punësuar me orar të plotë dhe tre pjesëtarë të stafit finlandez janë dedikuar për programin në fjalë. Megjithatë, prej 34 mësimdhënësve të listuar për këtë program, më shumë se 20 janë nga Finlanda, për të cilët nuk është bërë e qartë se si do të përfshihen në mësimdhënie. Mënyra e angazhimit të tyre nuk është bërë e qartë nga Kolegji ISPE, dhe e njëjta gjë u dëshmuar nga stafi i SeAMK që morën pjesë gjatë vizitës së vlerësimit, të cilët u shprehën se nuk ishin të informuar për detajet e angazhimit të tyre në mësimdhënie me studentët në Prishtinë. Ekipit të Ekspertëve nuk iu është paraqitur një plan ku përshkruhet saktësisht numri i mësimdhënësve që duhet të vijin nga Finlanda, për çfarë periudha kohore, çfarë përgatitje duhet të bëjnë para se të vijin etj. Deri në kohën e vizitës Kolegji nuk kishte një plan të tillë dhe gjatë intervistave u kuptua se bartësit e programit nuk kishin pasur kohë të mjaftueshme për ta përgatitur atë.

Sa i përket kapitullit të standardeve që ka të bëjë me përmbajtjen e procesit edukativ, Ekipit të Ekspertëve iu është prezantuar se rrjedha logjike e programit është marrë nga programi i cili është ofruar për shumë vite në SeAMK. Megjithatë, ekspertët ndërkombëtar mendojnë se programi duhet të adaptohet në mënyrë që t'i përshtatet kontekstit kosovar. Për më tepër, syllabuset nuk bëjnë një ndarje të qartë në mes të ligjëratave dhe aktiviteteve aplikative si dhe nuk përmbajnë listën minimale të literaturës. Po ashtu në kuadër të këtij kapitulli të standardeve ekipi i ekspertëve nuk ka arritur të gjejë evidencë të politikave dhe procedurave të cilat përfshijnë veprime që duhet të ndërmerren në rast të arritjeve të ulëta të studentëve apo në rast të vlerësimit jokonsistent.

Sa i përket kapitullit të standardeve që ka të bëjë me hulumtimin, ekspertët vlerësues kanë konstatuar se Kolegji nuk ka caktuar objektiva për hulumtim shkencor. Për këtë arsye vlerësuesit e kishin të pamundur të kuptonin nëse janë ndarë burime të mjaftueshme financiare, logjistike dhe njerëzore për hulumtim. Pos kësaj në raportin e vetëvlerësimit thuhet se ISPE dhe SeAMK do të inkurajojnë dhe ndihmojnë stafin që të

marrin pjesë në projekte kërkimore etj. mirëpo nuk ka asnjë evidencë se angazhimi i stafit në aktivitetet kërkimore ndërlihet me vlerësimin e stafit apo avancimin e tyre. Për më tepër ekspertët nuk kanë arritur të gjejnë politika të cilat përcaktojnë se cilat punime mund të njihen si punime shkencore e cilat jo.

Sa i përket kapitullit të standardeve që ka të bëjë me infrastrukturën dhe resurset, ekspertët kanë konstatuar se objekti i marrë me qera nga Kolegji ISPE, ku është planifikuar të fillojë programi, nuk është në gjendje të akomodojë 80 studentë, siç është kërkuar në aplikacion. Tutje, në kohën kur është zhvilluar vizita e ekspertëve vlerësues, është konstatuar se hapësirat e dedikuara për zhvillimin e programit nuk ishin të përgatitura në mënyrë adekuate për fillimin e procesit të mësimdhënies dhe hulumtimeve shkencore. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar nuk rekomandon fillimin e programit para se pajisjet dhe materialet e nevojshme, së paku për vitin e parë të studimeve, të jenë të instaluar dhe të gatshme për punë. Sa i përket qasjes së personave me nevoja të veçanta, objekti ku është planifikuar të ofrohet programi posedon një lift, mirëpo ekipi i ekspertëve gjatë vizitës nuk pati mundësi të shohë se si duket objekti i ri ku planifikohet të bartet programi pas një viti.

Në bazë të këtyre të gjeturave, ekipi i ekspertëve ka dhënë rekomandim negativ lidhur me akreditimin e programit të studimit Infermieri, BSc, 180 ECTS.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti

administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit ISPE
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë